


BIBLIOTEKA

8JH-1  
PA

# *Erind Pajo*



*Sikur pranë  
të kisha  
një zog...*

*lirika*

8JH-1  
PJA

# *Erind Pajo*

Баллада

Рус. НЕЛА

ПВТОР

ЗАНИМАНИЯ

*Sikur pranë  
të kisha  
një zog...*

*lirika*



СНТІПІА БОТУЕСЕ  
«НАІМ ФРАШЕРІ»

Библиотека

443  
445

*Redaktor*

ISUF NELAJ

*Piktor*

BUJAR MARIKAJ

Сибирь  
взять  
столица  
... горы

Марка

*Recensues:*

**Edor Gjergo**

**Rudolf Marku**



## FJONGOT PREJ DRITE

Sonte mia nuk mē fumet  
ndonemā pā gjumie jam.  
Shoh qyjetet  
M aq mirē qsho. Ildhur  
mē fjongo prej drite  
dixitai prej drite,  
qē vargjet o neomēre krojne nō, balevard,  
fjongove tē mēndusfēta,  
qē churatus e Vittit tē Ri  
u ngajnos.

## **F jongot prej drite**

Sonte mia nuk mē fumet  
I jupol prej drite li qyjetet.  
nugarjet e bormo  
me ato qē nesēt u tē nūdihin  
i lidhī, i Njōt btsñia.

Si likur ta ndiesh, kēd qđi natiē!  
T' ndiesh si lighen duit mē fjongo prej  
drīte.  
ta ndiesh te si drīte tē nūdihēm  
nūdihēm tē qjitha duit e jetēs vaga.

## FJONGOT PREJ DRITE

Sonte mua nuk më flihet  
ndonëse pa gjumë jam.

Shoh qytetin.

Ai aq mirë është lidhur  
me fjongo prej drite  
shiritat prej drite;  
që vargjet e neonëve krijojnë në bulevard,  
fjongove të mëndafshata,  
që dhuratat e Vítit të Ri lidhin,  
u ngajnjë.

Sonte mua nuk më flihet;  
Fjongot prej drite të qytetit  
ngjarjet e sotme  
me ato që nesër do të ndodhin  
i lidhin, i bëjnë bashkë ...

Sa bukur ta ndiesh këtë çdo natë!  
Të ndiesh si lidhen ditët me fjongo prej  
drite,  
të ndiesh se si shirita të ndritshëm  
përshkojnë të gjitha ditët e jetës varg.

## FONCET PERA DIBAT

### KORESPONDENCE NGA FUSHA

Bash këtu, në mes të fushës  
njëri-tjetrit i rrinë ballas  
një shtyllë betoni e një plep.

Plepit i vjen turp  
pse ashtu si shtylla  
s'është i drejtë.

Shtyllës prej betoni,  
ngaqë është pa jetë,  
s'i vjen dot turp  
që ashtu si plepi  
ajo nuk ka jetë.

## **ROZË, TË KUQE APO TË BARDHA?**

Degët e pemëve ishin plot me sythe  
dhe unë nuk e dija ç'do të çelnin:  
lule të bardha, rozë apo të kuqe.  
U viaj rrotull pemëve,  
por ato s'tregonin,  
sekretet i kishin mbyllur nëpër sythe.

Për një çast  
i harrova të tëra vogëlsirat e botës, me  
tjetër gjë më shqetësonë këtë çast:

Në ç'ngjyrë do të çelnin sythat,  
në rozë, në të kuqe apo në të bardhë?

KOKE, TE KUQE APO TE KUQE  
**MUZEU NË FORMËN E SHQIPONJËS**

I shihni këto pllaka të bardha mermari?  
Janë formuar qyshkur, ndoshta që në erën e paleozoit.  
U shkëputën ca kohë më parë diku nga gjiri i maleve, këtu u sollën  
për të ndërtuar Muzeun e Heroit.

Janë llogaritur të gjiltha pjerrësitë.  
Muzeu ka tash pamjen e shqiponjës.  
Shqiponjat e gjalla kaq here në mal  
mbi këto pllaka mermari janë ulur  
si të donin që sa më mirë  
t'ua mësonin formën.  
E tash pllakat e mermrit, që shqiponja mbi supe kanë mbajtur,  
krijojnë vetë pamjen e shqiponjës.

Ja, edhe shqiponjës,  
vetëm formën për muze i morëm,  
ngjyrën e zezë të përzishme  
me ngjyrën e bardhë të mermerit e  
dhimbjen e kthyem në forcë!  
  
Shqiponja vigane prej mermeri të  
bardhë,  
që në mes të Tiranës ka ndalur,  
me siguri këtë kërkon të thotë.

## **ANTIPARALELIZËM**

*Guaskë tē fortë midhja ka  
dhe prapë, brenda saj,  
jetën e vet tē mbyllur  
mezi e mbron.*

*Lëkurë krejt tē hollë ka njeriu  
por prapë, nën tē,  
më e madhërishmja jetë gjallon!*

## *S'TË PASKA ZËNË GJUMI*

*Ty ende s'të paska zënë gjumi.*

*As mua.*

*Unë shkruaj, ti po lexon.*

*Eshtë vonë, shumë vonë.*

*Ndonjë hall do kesh patjetër  
që të lë pa gjumë,  
të bën ta shtysh kohën duke lexuar;  
diçka do kem edhe unë,  
diçka që më bën të shkruaj.*

*Kot njerëzit pa gjumë s'rrinë.*

*As ty s'të ka zënë gjumi,  
as mua.*

## MONOLOGU I LETRAVE TË BARDHA

*Ne jemi ende të bardha!*

Sytë e poetit janë të trishtë,  
kur vërejnë se jemi të bardha.

Sytë e atijqës poein urren  
janë të lumtur kur zbulojnë  
se jemi ende të bardha.

Por, për shumë kohë  
kështu s'do të mbesim:  
ne do ta lumturojmë poetin,  
ne do ta ligështojmë urrejtësin.

Paçka se tash ende jemi të bardha,  
ne, për shumë kohë, kështu s'do të mbesim.

## **MAGJIA E LETËRSISE**

Mësuesja hyn në klasë  
dhe si për çudi  
klasa e zhurmshme bie në qetësi.  
Qetësi të tillë nuk njoihu kjo klasë  
edhe kur mësues të zymtë  
formula të stërgjatura  
shkruanin në dërrasë.  
Edhe kur drejtori vinte atje,  
lëvozhga farash të pjekura luledielli  
vazhdonin nxënësit  
të hidhnin përdhe ...  
  
Hyn letërsia në klasë,  
qetësi.  
Tani vetëjeta do të flasë!

## **INTERVISTË DETIT**

(Poemth)

1.

Eci përpara Detit,  
përpara të intervistuarit tim të pagojë.

— Mirëmbrëma, shoku Det!

Heshtje.

Deti nuk flet.

Žakonisht intervistat fillojnë  
me pyetjen shabllon:

— Kur keni lindur, shoku X,  
në ç'vit veprimitaria juaj fillon?

Dhe shoku X, babaxhan, nis të tregojë,  
gjë që s'e bën Deti,  
i intervistuari im i pagojë.

Ndërkaq, datën kur ka lindur X-i  
të gjithë e dinë  
dhe përgjigja s'u intereson.

Po Deti, kur ka lindur ai vallë?

17



*Deti prapë hesht  
dhe asgjë s'tregon.*

*Deti është i pagojë  
por prapë, kur do, flet,  
flet në të gjitha gjuhët e botës,  
i të gjitha gjuhëve është poet!*

2.

*Poeti i madh Det,  
që vargje reciton  
me gjuhën e valëve,  
nuk ka librezë anëtarësie  
të Lidhjes së Shkrimtarëve.*

*Poeti i pagojë Det,  
reciton vargje të lirë, të bardhë  
që shkasin nga bardhësia e shkumës  
valë më valë,  
Për këtë s'ka faj.  
Ai s'ka bërë shkollë për shkrimtar.*

*Deti,  
që vargje reciton me gjuhën e valëve,  
nuk ka librezë anëtarësie  
të Lidhjes së Shkrimtarëve.*

3.

*Edhe në intervistë Deti  
ditëlindjen sekret e mban,  
ndaj në përvjetor  
askush s'i dërgon telegram.*

*Ti, Det,  
nuk iu përgjigje pyetjes së parë.  
Ti fare herët ke lindur  
dhe ndoshta druan  
se të themi «plak».*

*Ti, je poet, Det,  
dhe si poet  
gjithmonë i ri do të jesh,  
kurrnjëherë plak.*

*Eh, Det,  
Ti prapë nuk përgjigjesh!  
Ta dish,  
unë shumë më kollaj  
do të intervistoja shokun X.*

4.

*Shokun X në Tiranë e gjej lehtë  
dhe s'më duhet të bëj kaq rrugë  
siç bëra për të ardhur tek ti, Det,*

*Por rrugën në mes s'mund ta lija,  
do të intervistoja ty, Det.*

5.

*Natën e mirë, Det!*  
*Tash, andej nga erdha do të vete.*  
*Interviewën tënde,*  
*shkruar nxitimthi në bllokun e shënimave*  
*do ta marr me vete.*  
*Do ta marr me vete në Tiranë,*  
*në Tiranën ku s'ka det*  
*dhe njerëzit*  
*të përmalluar për detin janë.*

*Në Tiranë det s'ka,*  
*por ka redaktorë,*  
*anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve.*  
*Kur t'u çoj për ta botuar interviewën*  
*shpejt në makina do të hipin këta,*  
*do rendin të arrijnë pranë dallgëve.*

*Dhe, skeptikë,*  
*do të të pyesin ty, Det:*  
— *Ej, ti!*  
*Ti e ke dhënë interviewën, vërtet?*

(korrik '88)

## *E KA EMRIN DITË*

*Dita lind natën.  
Pak, pas orës 24.*

*Dita vdes natën.  
Pak para orës 24.*

*Dhe me gjithëse natën  
edhe vdes, edhe lind  
emrin e ka DITË.*

## **KONSERVATORIZËM**

Emrin tënd në syprinën prej xhami të  
tryezës  
e shkrova;  
pastaj, i trembur mos të tjerë e shihnin,  
me gisht e fshiva.

Pastaj prapë e shkrova  
dhe prapë e fshiva.  
gjersa qelqi mori ngjyrën e kaltër të  
bojës së shkrimit . . .  
Diç më pengonte mos ta fshija,  
le ta shihnin atë emër të gjithë.

## *KUR ATA IKËN*

*I fola natës:*

— *Pse s'shkon dhe ti?*

*Të gjithë ikën,*

*më lanë vetëm, më braktisën.*

*Më foli nata:*

— *Po unë jam jotja,*

*jotja është edhe dita,*

*me ty është dielli,*

*dhe retë e bukura,*

*edhe qielli.*

*I fola natës:*

— *Po ata ikën,*

*vetëm më lanë, më braktisën!*

— *Vetëm nuk je,*

*bashkë jemi,*

*me ne është edhe Dielli*

*Reja e bukur edhe Qielli.*

## *NDARJE ME GJYSHIN*

*Dhe gjyshi iku.*

*Natën me sy kontrollonte,  
rrugën kontrollonte me shkop.*

*Dhe unë në prag të derës mbeta.*

*Dhe brenda  
s'po hyja dot.*

*Dhe ishte shumë trishtuese  
kjo ikje e gjyshit nëpër natë,  
trishtues ish zvogëlimi i tij  
sa më tepër i afrohej  
fundit të rrugës së gjatë...*

*.... dhe unë pastaj brenda u futa,  
duke mbetur jashtë  
tërë atë natë.*

## **LULEDELET E KOSITURA**

*Dëgjova ca vazja t  vogla  
q  nj ra-tjetr s i thoshin me trishtim:  
— Ej, goca,  
k tu bashk  me barin e rritur  
edhe luledelet i kan  kositur!*

*M  erdhi shum  keq, v rtet,  
p r luledelet dhe p r vajzat e vogla  
e aty p r aty e mora inat p rgjegj sin  
e lulishtar ve,  
aq sa, po ta kisha pasur n  dor ,  
do ta kisha detyruar  
luledeleve t  k putura t u k rkonte falje...  
Po un  nuk e kam n  dor ,  
un  vet m k t  vjersh  mund t  shkruaj —  
— vjersh n nuk e lexon p rgjegj si  
i lulishtar ve ...*

*Ndaj ai sillet si t  doj  me luledelet,  
nda lulishtar t prap , me kosa  
i k pusin luledelet-e vogla,  
i trishtojn  vajzat e vogla,  
i b jn  t  th rrasin:  
Ej, goca ...*

## *I NDJEJ SYTË*

*Edhe pse krejt të vegjël janë,  
i ndiej sytë e njerëzve që larg:  
Janë duke më parë,  
apo s'janë duke më parë,  
apo bëjnë sikur s'më kanë parë,  
apo s'duan të më shohin,  
apo s'munden të më njohin,  
apo diçka më fshehin,  
apo diç më shumë duan të më thonë,  
apo duan të më harrojnë,  
apo s'duan me sytë e mi të bisedojnë  
... ndaj më flasin me gojë.*

**1989**

## **SIMFONIA E PËRVJESHTSHME**

*Dy zogj gri, të qullur nga shiu  
u ulën mbi bulevardin e mbushur me gjethe  
të rëna  
dhe po shkundin tash  
krahët e tyre të lagëta.  
Ia bëjnë zogjtë «ciu-ciu» . . .*

*Kalojnë rrugës shkujdesur,  
diç duke biseduar  
e duke buzëqeshur,  
ca vajza.  
U kërcasin nën hapa  
me dhjetra gjethe të thata...  
Dëgjojnë kërcitjen zogjtë,  
ngrihen në ajër  
dhe fluturojnë në valle të ëmbël  
nën piklat që lëshojnë krahët e njëri-tjetrit...  
(Krejt kështu, ju betohem,  
s'kanë kërcyer kurrë ndonjëherë njerëzit.)*

*A mund ta quajmë tash zhurmë  
kërcitjen e gjetheve nën hapa?  
Jo, kurrsesi jo!  
Ajo është muzikë!*

*Ta quajmë:  
simfonia e përvjeshtshme  
«Kërcitja e gjetheve të thata».*

## **S I K U R**

*Sikur të ishte diku një dylbi e madhe  
gjithë prej kristali,  
unë do ta merrja patjetër  
dhe me të  
do t'i shikoja zogjtë që janë larg.  
Ata do të më dukeshin afër.*

*Sikur pranë të kisha një zog,  
unë do ta puthja zogun...*

*.. dhe çika-çika do ta bëja kristalin,  
sikur dylbinë e madhe të ma falnin.*

## STAV AM VIEGEM ALZUZIM

### QË KUR LINDIN LULET

Që kur lindin luleti  
me dheun bien në dashuri,  
rrënjet në të fort i ngulin,  
i thithin dheut të fshehtat e tij.

Vërtet që të bukura lulet janë,  
por janë të shtangëta disti,  
ndoshta të bukura bëhen pér dheun,  
ndoshta shtangen nga të fshehtat e tij.

## **MËSUESJA MENDONTE ME VETE**

Sytë janë si një skëdar i madh  
ku vetja jote regjistrohet:  
*Kush je tash,*  
*kush ke qenë më parë,*  
*kush do të jesh më pas.*

Në çdo orë,  
në çdo klasë,  
shfletoj më mijëra skeda  
nga këtë skedarë.

**1989**

## TUJU ÆSTAKA

**A E KE PARË NGJYRËN E DIELLIT?**

Ngjyrë e diellit qëndron me vëllësi  
që marrëntur gjithë

qëndrojnë qëndruesisht nuk mundet t'u

*Kur të thashë se ajole s'mund të lëshuar  
i ka flokët në ngjyrën e diellit, nom iku  
ti andej ktheve kokën e buzëqeshe.*

— *A e ke parë*

*ngjyrën e diellit vallë? qëndrojnë  
Sigurisht që s'e ke parë! Në bëjët e tij  
Edhe po të jesh përpjekur, qëndra  
dielli, sytë t'i i ka djequr, qëndra  
të ka bërë përtë qarë!*

*Unë prapë këmbëngula  
se ngjyrën e diellit  
në flokët e saj e kam parë.*

*Mos buzëqeshni!*

*Ndofta ju vetë diellit  
ngjyrën ende s'ia keni parë.*

## ËSHTË NJË ÇAST

Jetojmë kohën e shpejtësive kozmike,  
jetojmë kohën e ndryshimeve të shpejta.  
S'është moderne sot  
të lexosh lirika të shkruara me gërma gotike,  
s'është moderne kohën ta shkosh  
duke menduar për pulëbardhat krahëlehta...

E prapë, është një çast kur vetja tē duket aq plak, sajeta,  
kur vetja tē dwket aq iari, sajeta,  
kur bashkë me pulëbardhat fluturon mbi det,  
kur ndien se po jeton vërgjeti e vjetra!

Është një çast  
kur edhe pse  
moderne si shpejtësítel kozmike  
e vërtetë si pulëbardhë ështëjeta.

Është një çast që pragmbërëmje, thirrat  
shpesh.

— چالىقىپ سەرىن ئەن ئەلىقىپ ۱  
ئەندەنەنەن ئەن ئەلىقىپ ۲  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۳  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۴  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۵  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۶  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۷  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۸  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۹  
ئەن ئەنىپ ئەن ئەنىپ ۱۰

### **JASHTË BIE SHI**

— چەللىقىپ گەورەق ئەلىقىپ ۱  
چەللىقىپ گەورەق ئەلىقىپ ۲  
چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۳  
چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۴  
**Jashtë bie shi**, چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۵  
پىكا تە medha nê pellg zhyten چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۶  
nuk lënë që چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۷  
mbi siperfaqe tê pasqyrohet چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۸  
një ulli.

E bëjnë këtë, چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۹  
pa vetë le tê imbyten چەللىقىپ گەورەق ئەنىپ ۱۰

## **A N I**

*I pulite një herë qepallat —  
— qerpikët u bënë shpata.  
Fatkeqësinë,  
si ushtarin pa armë e vranë  
e në veten time s'mbeti gjë nga disfata.*

## **IRK TIRI TAKRA**

*I pulite prapë qepallat —  
— qerpikët u bënë flatra të kaltra.  
Fluturova me to mijëra kilometra  
në thellësinë disamilimetërshe të syve të tu;  
siç fluturover tij. Dhe qëndroj si u  
brenda syve të mi.*

*Pastaj luajte buzët:*

*«àni, àni,»  
por që e panevojshme,  
tashmë po fluturoja në kaltërsi.*

## TRADICIONALNA LITERATURA

TRADICIONALNA LITERATURA

### PEIZAZH

Na vërtet që nuk ka qetësi  
që këtë peizazh nuk mund t'i përcaktoj,

Toka që sapo qe plehëruar,  
erë të keqe lëshonte qetësisht.  
Dukej si kapak i guaskës së detit  
dhe qelli, kapaku tjetër i shqitur ish.

Një vajzë, së shumë e veshur qëndrueshëm  
që me bicikletë vinte prej qytetit,  
ndodhej në pikën ku guaska  
margaritarin mban zakonisht.

## **THASHETHEMETJERRËSIT BUZË DETIT**

*Tani në mëngjes* **thashethemetjerrësit** ulen në stola buzë **detit.**

*Me seriozitetin e peshkatarit*  
*valët vështrojnë*,  
*si peshkatarët*,  
*që peshk me gropa zënë*,  
*ata zënë me gojë njerëzit,*  
*marrin nëpër gojë njerëzit..*

*... Ulen thashethemetjerrësit* në *stola buzë*  
*dhe me thashetheme,*  
*plaken vetë; e plakin mëngjesin.*

... oħra - Innu minn  
niċċek u ġejja, u dar il-kunċi għad-did idha  
miedha għejja sej-ġejja - qiegħi u kien

... noppo minn, u tgħid lu - idha minn  
idha ja' kien kien minn  
ja' hawn - Ma - ja' kien kien minn

... minn u kien kien minn  
idha minn - idha minn  
ja' hawn - Ma - ja' kien kien minn

## **R R U G È S**

... idha minn  
idha ja' kien minn

**Tē lustruara pēr mrekulli janē kēpucēt.**

... idha minn - idha minn  
**Shkëlqejnē kur ka sdiell rrugħ,** - - - - - - - - -  
tē sémura duken  
**kur nuk ka diell rrugħ.**

## **S F I D A**

*Mimozat çelën.*

*Si çdo herë, ngjyrën e kishin tepër të bukur  
dhe erën — tepër të këndshme.*

*Vitin tjetër pati plot shtrëngata,  
ra gjithë ai shi.*

*Mimozat çelën përsëri.*

*Vitin tjetër qe thatësirë e gjatë,  
nuk ra fare shi.*

*Mimozat çelën përsëri.*

*Vitin tjetër . . .*

*Mimozat çelën!*

*Si çdo herë, ngjyrën e kishin tepër të bukur  
dhe erën — tepër të këndshme.*

**Vajza  
dhe Reja**

## **QEMË MIQ DIKUR**

Qemë miq dikur,  
aq miq sa vetëm ne e dimë,  
flitnim gjithfarë gjërash bashkë,  
mbarë dhe mbrapsht  
*e fjalët kishin ngjyrën e qiellit . . .*

Po ja që qielli  
nuk është gjithmonë i kthjellët,  
shumë herë edhe re ka ai,  
re të zeza si fytyra piratësh,  
re që s'dinë veç të hedhin shi.

Fjalët-re djo mua m'i drejtoi, për çudi.  
Sikur ato thelle mos t'i kuptoja;  
përjetë do më kishin lagur më shi.  
Por unë s'u tremba prej tij.

Nga fjalët-re? As nga ato!  
Veç, keq më erdhë  
që shiun ma drejtonte ajo.

## KUĆA D'OMA ZA KATOLIK

... mire peregrinat...  
Jombe e peregrinat... peregrinat  
S'and vitezat... peregrinat...  
Vedetore... peregrinat

... mire peregrinat...  
Jombe e peregrinat... peregrinat  
S'and vitezat... peregrinat...  
Vedetore... peregrinat

... mire peregrinat...  
Jombe e peregrinat... peregrinat  
S'and vitezat... peregrinat...  
Vedetore... peregrinat

## FJALË E GJUHËS SË HUAJ

Kishte kohë që s'qemë takuan,  
po pér ty nuk ndieja mall,  
Ndoshta, krejt t'kisha harruar ob siç  
siç harrohet në gjuhën e huaj  
një fjalë.

(Sa mijëra fjalë mund të ketë  
një gjuhë e huaj vallë!?)

ANGLAKSHYA E KALU  
PARU LAKHNA 42

### UNE DHE LIQENI

Kur isha dje nga liqeni pashë se gati sa skish shteruar,  
vetëm pak ujë i kish mbetur përfund,  
sikur dielli ta thante kish harruar.

E m'u duk se liqenit shumë i ngjaja,  
si atij dielli, mua koha gjithë kujtimet e saj m'i shteroi,  
e të shtonte aty diçka tjetër  
ajo krejt harroi . . .

Pa ujë s'mund të quhej liqeni,  
pa të edhe une s'mund të isha ai  
e këshfu ne të dy pritnim,  
ai pikat e shiut,  
une . . .  
as vëtë nuk e di

## **UDHA E PËRRALLAVE, PËRRALLAT E UDHËS**

Udha shtrihet përpara,  
rrrethuar nga të dyja anët me plepa.  
Udha shtrihet përpara,  
rrrethuar katëranësh me dite e hate.  
Udha shtrihet përpara, udha shtrihet edhe  
pas.

Udha është shtëpia e përrallave;  
shtëpi si çdo shtëpi  
me dyet, me drithare, me tavat,  
në dimër e ngrohtë, në verë e freskët  
përrallat gjallë i mban.

Përrallat në udhë janë udhëtarë  
hipur në kuaj të djersitur e të lodhur,  
që rendin e rendin papushim,  
që s'gjejnë kohë përtu glodhur,  
Natën me bisturi dritash po ta çash,  
mund të shohësh anash dhë përballe  
të gjithë heronjtë dhe heroinat e përrallave,  
ca duke qeshur, ca duke qarë.

Ca tē veshur me rrroba tē bukura  
tē kuqe, tē blerta, tē kaltra;  
Ca me zhele që ngjyra s'u dallohet,  
ca që kanë flatra, ca që s'kanë flatra.

---

Por, ashtu si përrallat udhën shtëpi kanë,  
edhe udha ka përrallat e veta,  
përralla që me tē parat s'ngjajnë,  
përralla, që s'janë përralla, me burokrate  
që papritur edhe përpnjë fjalë tē mbajnë  
inat.

Dhe janë disa njerëz tē vegjël  
tē vegjël sa një grimcë pluhuri.  
Për ta edhe një shef i vogël  
është më i fuqishëm se Muji.

Udha duhet pastruar nga pluhuri!  
Jo me shtëllunga, por s'duhet tē mbesë një  
grimcë!  
Udha është shtëpia e përrallave,  
shtëpia e përrallave s'duhet tē jetë pis.

UDHA E PERRALLAVE,  
PERRALLAT I UDHE

Cu si udha e perrallave  
Cu si udha e perrallat i udhe  
Udha shtrihet pérpara.  
*Ju njerëz!*  
*Ju që përrallat i pëlqeni,*  
*ju që pér Hirushen keni qarë;*  
*ju që princa, kalorës apo qerosë keni qenë,*  
*ju që Gjergj e keni ndierë veten,*  
*ju që bajlozë keni vrarë!*  
*Ju gjithnjë e pastroni udhën nga pluhuri!*  
*Ju mund ta bëni pse jeni të fortë si Muji!*

Udha shtrihet pérpara,  
rrethuar nga të dyja anët me plepa.  
Udha shtrihet pérpara,  
pérpara me mijëra kilometra.

*LOJA E DRITËS, LOJA E RIJES*

Kaknëtë një mizë

para burri, para vajzës

dhe hije të madhe

teshtësia jerdhe.

Aç e madhe që hija,

Vejevi në rruginat e lulishtes.

Këtu, nga gjithë ato hapa,

më e pakta,

lëviz një pllakë në çdo tri pllaka.

Mendimi im

si një shëtitës i natës,

si një i vonuar, i vëtmuar,

vejevjen fjalive e fjalëve të tua

derisa fjalitë bëhen rrugina të lulishtes

dhe pllaka bëhen të tuat fjalë.

Unë dhe mendimi im

vejevijmë vërdallë.

Në rruginë lëviz tani çdo pllakë,

në fjalë vallëzon tani çdo fjalë.

## **V AJZA DHE REJA**

*Reja rrethuar prej yjesh që duken siç kanë  
qenë /qindra vjet më parë,  
Vajza rrethuar prej vështrimesh që të tilla  
/kanë qenë përjetë.  
Sytë e resë-vrima boshe në mes të hapësirës,  
në sytë e vajzës ngjyra e hirit tregon  
/mjedis zjarri.  
Goja e resë, e madhe, sa nxe edhe yjet,  
goja e vajzës, e vogël, as emrin tim s'e nxe  
dot . . .*

*Reja, lartë në qiell;  
vajza, poshtë, në tokë.*

## *LOJA E DRITËS, LOJA E HIJES*

*Kalonte një mizë  
para burimit të dritës  
dhe hije të madhe  
lëshonte përdhe.*

*Aq e madhe qe hija,  
saqë mbulonte  
një mace që flinte atje.*

*Hija e maces, pra,  
qe e vogël krejt,  
dhe dikush,  
veç hijet duke parë, mund të thotë  
që miza  
më e madhe është nga macja vetë ...*

*Lot drita,  
me macen, me mizën,  
me ne vetë;  
lot dhe me hije thotë:*

*S'ka nevojë i madh të jesh,  
mjafton që dritës së tjegrit t'i afrohesh  
dhe boll hije  
do lëshosh.*

## 23. FRYU ERA

### FRYU ERA

Fryu era  
dhe t'i trazoi çmendurisht  
flokët e bukur, të verdhë;  
duke bërë kështu  
trazoi edhe mendimet e mia.  
  
Me qelqet e dritareve  
gjithë natën bisedoi pastaj era,  
flokët e trazuar më kujtoi  
dhe s'më la të flija...

ARTIKULI I AVVAMOS

ARTIKULI I

**P R I T J E**

Të prita shumë atë mbrëmje.

Ajri i bardhë që nxirrja nga goja  
shponte terrin e natës  
dhe mua më dukej  
se formoheshin shkronja.

Shkronja latine, gotike, cirilike . . .

Ti prapë s'po vije.

Të gjitha m'u dukën hieroglife.

**NDJENJË E ÇUDITSHME,  
E NDËRMJETME**

ANNA

Ditën;

më dukesh siç duket nata ditën,

— **E BUKUR**

Natën, më dukesh siç duket ditë natën,

më dukesh siç duket ditë natën,

— **E BUKUR**

Gjithë ditën —

— sytë e mi mallohen për natën; Dëgja III

gjithë natën —

— sytë e mi mallohen për ditën.

## M A L L I

Në qielj çdo çast  
ka re me emra e ngjyra të ndryshme,  
që sipër irruzullit sllen vërdallë,  
që kufijtë ndërshtetërorë kapërcejnë,  
që s'ndalin në asnjë doganë...

Sa ndahemi bashkë,  
nidiej se më kapërdin  
një re e madhe, e bardhë;  
sa ndahemi bashkë  
nidiej se kapërdij  
një re të stërmadhe, të bardhë.

E përherë bëj çudi.  
Si futet brenda meje  
kjo re e stërmadhe, e bardhë,  
me emrin, e saj, bojëloti,  
me emrin «mall»?

Sapo që ti s'je më pranë,  
vjen e futet tek unë kjo re e bardhë ...

## A U T O P O R T R E T I

Të isha piktor,  
ja ç'do pikturoja për autoportretin:

Një simfoni, që e ekzekuton një orkestër marroke  
Dirigjenti, i téri prej tymi dhe ere,  
tund andej — këtej një portaminë

me majë të mbaruar, me plot maya të panisura brenda.  
Dikujt zeropesëshe,

më tepër i pëlqen muzika se ekzekutimi  
ose i pëlqen ekzekutimi  
më tepër se muzika;  
ose të dyja i pëlqeijnë,  
ose s'i pëlqen asnjerë.

Një pyll  
ku kanë mbirë shkurre, bar, pemë  
ku herë fryn erë, herë s'frynn erë,  
ku ka edhe mjaltë edhe arinj.  
Një pyll që, kur bie nata,  
e ka tavanin me hënë e 'me yje.

*Pyll që në një krah ka lumin,  
në një krah humnerën  
e pas lumiit apo humnerës  
prapë pyje.*

*Një përrallë,  
që i pari e tregoi një plak  
që kishte një dhëmb të dalë  
dhe pastaj mijëra herë u tregua  
dhe pastaj u shkrua në letër të bardhë  
nga një stilograf me majë të artë.*

*Dhe mbi të gjitha këto,  
dhe nën të gjitha këto,  
dhe midis gjithë këtyre  
tingujt e metaltë:  
Tik-tak.*

*Një dy tre... njëqind vjet...  
Hë, sa do rrosh?  
Mos vallë kaq?*

*Dhe përgjigja e metaltë:  
— Piktura do rrojë edhe më pas.*

and I am very much  
interested in the  
chromatic organ. Very  
soon after we get

there I will go  
to see it. I have  
had a good deal  
of time to think over  
the matter and I am  
now quite satisfied  
with my plan. I  
will go to see it  
as soon as possible  
and if you like I  
will take you with  
me.

Very truly yours,  
John C. H. Morris

John C. H. Morris

John C. H. Morris

## PËRMBAJTJA

### FJONGOT PREJ DRITE

Fjongot prej drite .....	5
Korrespoñdencë nga fusha .....	6
Rozë, të kuqe apo të bardhë? .....	7
Muzeu në formën e shqiponjës .....	8
Antiparalelizëm .....	10
S'te paska zënë gjumi .....	11

### INTERVISTË DETIT

Monologu i letrave të bardha .....	15
Magjia e letërsisë .....	16
Intervistë Detit (poemth) .....	17
E ka emrin Dité .....	21

### APÓ DIC MË SHUMË DUAN TË MË THONË

Konservatorizëm .....	25
Kur ata ikën .....	26

Ndarje me gjyshin .....	27
Lule delet e kositura .....	28
I ndjej sytë .....	29
Simfonia e përvjeshtshme .....	30
Sikur .....	32
Që kur lindin lulet .....	33
Mësuesja mendonte me vete .....	34
A e ke parë ngjyrën e diellit? .....	35
Eshtë një çast .....	36
Jashtë bie shi .....	37
Ani .....	38
Peizazh .....	39
Thashethemetjerrësit buzë detit .....	40
Rrugës .....	41
Sfida .....	42
<b>VAJZA DHE REJA</b> .....	43
Qemë miq dikur .....	45
Fjalë e gjuhës së huaj .....	46
Unë dhe liqeni .....	47
Udhë e përrallave, përrallat e udhës .....	48
Rruginave .....	51
Vajza dhe reja .....	52
Loja e drithës, loja e hijes .....	53
Fryu era .....	54
Pritje .....	55
Ndjenjë e çuditshme, e ndërmjetme .....	56
Malli .....	57
<b>Autoportreti</b> .....	58

Pajo, Erind

Sikur pranë të kisha një zog... :  
Lirika /Erind Pajo; Red.: I. Nelaj. —  
T.: Naim Frashëri. 1990. — 64 f.;  
18 cm

891.983-14

P 17

Tirazhi 1500 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82  
KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re,  
Tiranë 1990



### **ERJIND PAJO**

*Ka lindur në Tiranë më 1972. Eshë nxënës në shkollën e mesme «Sami Frashëri», në Tiranë.*

*Ka botuar poezi në organet e ndryshme të shtypit dhe ka fituar çmim në konkursin e 45-vjetorit të çlirimit të atdheut për poemën «Intervistë detit».*

*Boton në shtyp përkthime nga anglishtja dhe gjermanishtja.*